

Udhëzim karriere dhe studimi si dhe mbështetje ekonomike gjatë shkollimit

Fondi i sigurisë TSL mund të ndihmojë të zhvillosh aftësinë tënde, për të forcuar pozitën tënde në të ardhmen, në tregun e punës. Në mbështetje përfshihen, udhëzimi profesional i karrierës dhe i studimit si dhe mundësitë për mbështetje ekonomike, nëse ti dëshirosh të ndjekësh një shkollim.

Me mbështetjen mund të thellosh njohuritë në rolin tënd të tanishëm, të zgjerosh aftësinë tënde, ose të ndërrosh profesion pjesërisht a plotësisht. Kjo të bën që të jesh atraktiv dhe konkurrues në tregun e punës.

Mbështetja përfshihet në atë marrëveshje kolektive, e cila vlen në vendin tënd të punës dhe kjo është falas për ty,

Kështu bëhet:

1. Kërkesa

Ti fillon me vizitë tek TSL.se, ku mund të lexosh edhe më shumë për mbështetjen dhe ta bësh kërkesën tënde, për të marrë udhëzime.

2. Kontakti

Pas kërkesës, në të kontaktojmë ty, për bisedën e parë udhëzuese, për të folur për gjendjen tënde dhe për mundësitë e tua.

3. Udhëzimi

Nëse ti dëshiron dhe ti ke nevojë për udhëzime më të thella karriere dhe studimi, përmes më shumë takimeve të tjera me ne.

4. Shkollim më të shkurtër apo më të gjatë

- Nëse ti dëshiron të ndjekësh një shkollim, i cili është më i shkurtër se pesë ditë, ti mund të kesh të drejtë të marrësh mbështetjen ekonomike, nga Fondi i sigurisë TSL. Nëse ne miratojmë mbështetjen, ti i merr parat e tua, muajin tjetër, pas kryerjes së shkollimit.
- Nëse ti dëshiron të ndjekësh një shkollim, i cili është pesë ditë apo më i gjatë, ti mund të kesh të drejtë të marrësh mbështetjen e përshtatur të shkollimit nga CSN, si dhe më shumë mbështetje ekonomike, nga Fondi i sigurisë TSL. Ne mund të ndihmojmë ty, me kërkesën e CSN-it. Nëse miratohet mbështetja, ti fillon t'i marrësh parat e tua, kur të filloj shkollimi yt.

Kushtet për të marrë, udhëzime karriere dhe shkollimi:

- Ti je i punësuar në një ndërmarrje, me marrëveshje kolektive, në kuadër të Industrisë dhe Tregtisë Suedeze dhe të Organizatës Sindikale të Suedisë dhe fushës së marrëveshjeve të tyre.
- Ti ke punuar, së paku 12 muaj, nga 24 muajt e fundit.
- Ti je nën 65 vjeç.

Kushti themelor për të marrë mbështetje ekonomike:

- Ti ke punuar, së paku 12 muaj, nga 24 muajt e fundit.
- Ti ke punuar, së paku 8 vjet, nga 14 vitet e fundit.
- Ti je, në mes 27 dhe 62 vjeç.

Vlejnë edhe kushte të tjera, për të cilat informohesh, kur të kesh kontakt me ne. Mbështetja ekonomike kompenson, deri në 80 për qind, të të ardhurave tua normale, gjatë kohës që ti shkollohesh. Ti mund të marrësh mbështetje ekonomike, më së gjati, 44 javë (ose 10 javë, pas vitit që ti i mbush 60 vjet)

Më shumë informacion dhe më shumë ndihmë personale

Më shumë informacion për mbështetjen, ka në uebfaqen tonë, TSL.se. Lartë, në uebfaqe ka mjete ku mund të ndërrosh gjuhën.

Je i mirëseardhur të na kontaktosh ne, për ndihmë.

- Pärmes telefonit: 010-480 91 20
- Pärmes e-postēs: info@tsl.se